



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2019:198955
Datë: 23.10.2024
Numri i dokumentit: 06338706

K.Dh.Shk.II.nr.1133/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtarja Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Krenar Berisha dhe Ramush Bardiqi anëtar të kolegjit në çështjen juridike vërtetim pronësie të paditësit S.N., nga Zveqani, rr. "...", nr.32, kundër të paditurit T.M., nga Zveqani, rr. "...", nr.38, e përfaqëson sipas autorizimit Agim Lushta avokat nga Mitrovica, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti i Përgjithshëm KP.nr.43/22 të datës 05.10.2022, me datë 10.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurit T.M., nga Zveqani, rr. "...", ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë -Departamenti i Përgjithshëm KP.nr.43/22 të datës 05.10.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykatës Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti i Përgjithshëm me aktvendimin e ankimuar KP.nr.43/22 të datës 05.10.2022, në pikën I të dispozitivit, është shpallur jo-kompetent në pikëpamje lëndore për vendosjen e kësaj çështje juridike, ndërsa në pikën II të dispozitivit pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, shkresat e lëndës ti dërgohen

Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, si gjykatë kompetente në pikëpamje lëndore për vendosjen e kësaj çështje juridike.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i padituri T.M., nga Zveqani, rr. "...", për shkak të shkeljes së dispozitave të procedureës kontestimore, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjës faktike si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurit T.M., nga Zveqani, rr. "...", dhe të ndryshohet aktvendimi e Gjykatës Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm KP.nr.43/22 të datës 05.10.2022 dhe të caktohet kompetencë lëndore Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti i Përgjithshëm.

Paditësi nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

Ankesa e të paditurit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit S.N., nga Zveqani, rr. "...", nr.32, me datën 31.01.2017 ka paraqitur padinë për kontestin e anulimit të kontratës dhe vërtetimit të pronësisë, kundër të paditurit T.M., nga Zveqani, rr. "...".

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti i Përgjithshëm, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KP.nr.43/22 të datës 05.10.2022, në pikën I të dispozitivit, është shpallur jo-kompetent në pikëpamje lëndore për vendosjen e kësaj çështje juridike, ndërsa në pikën II të dispozitivit pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, shkresat e lëndës ti dërgohen Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, si gjykatë kompetente në pikëpamje lëndore për vendosjen e kësaj çështje juridike.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se në rastin konkret, vlerëson se kjo çështje nuk bie në domenin e kompetencës lëndore të Gjykatës Komerciale. Sipas Ligjit për Gjykatën Komerciale, mbështetur në nenin 13, par 1. lidhur me par. 1.7 të Ligjit për Gjykatën Komerciale (Ligji nr. 08/L-15) i cili përcakton: *"1. Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë": në vazhdim par. 1.7" kontestet në mes shoqërive tregtare lidhur me të drejtat sendore, siç është e parapare me Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare"*. Referuar dispozitave të lartë cekura, Departamenti i Përgjithshëm pranë Gjykatës Komerciale është kompetent për shqyrtimin e kontesteve në mes të shoqërive tregtare të përcaktuar në Ligjin për Shoqëri Tregtare. Në këtë çështje juridike, palët në procedure nuk janë shoqëri tregtare të përcaktuar në Ligjin për Shoqëri Tregtare, por persona fizike, prandaj bazuar në nenin 12 dhe 20 të Ligjit për Gjykata (Ligji nr. 06/L-054), si dhe bazuar në nenin 41 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (Ligjit Nr.03/L-006), i cili përcakton kompetencën e veçantë territoriale (kompetence territoriale ekskluzive) të gjykatave në territorin e të cilit gjendet paluajtshmëria, për kontestet lidhur me të drejta mbi sendet e paluajtshme, meqenëse edhe objekt kontesti ishte vërtetimi i pronës, e sipas kësaj dispozite është e rregulluar kompetenca territoriale ekskluzive, kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Gjykata Themelore në Mitrovicë Departamenti i Përgjithshëm.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale e pranojnë vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK apo të dispozitave të së drejtës materiale, e të cilat shkaqe ankimore i vështron gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kolegji i gjykatës së shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur ka vendosur që të shpallet jokompetente për shkak të mungesës së kompetencës lëndore të kësaj gjykate për të vendosur në këtë çështjet ku palë paditëse është S.N., nga Zveqani, rr. "...", nr.32, kundër të paditurit T.M., nga Zveqani, rr. "...", nr.38, ngase duke ju referuar Ligjit për Gjykatën Komerciale, gjegjësisht neni 13 i cili përcakton se : *"1. Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së*

Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë": në vazhdim par. 1.7" kontestet në mes shoqërive tregtare lidhur me të drejtat sendore, siç është e parapare me Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare" e që në rastin konkret shifet se palët në procedure nuk janë shoqëri tregtare të përcaktuar ashtu sipas Ligjin për Shoqëri Tregtare, por janë persona fizike të cilët të njëjtit si persona fizik paraqiten në padi e edhe kontratën e datës 30.04.2008 të njëjtit e kanë nënshkruar personat fizik, e për më tepër edhe sipas nenin 12 dhe 20 të Ligjit për Gjykata (Ligji nr. 06/L-054), e edhe sipas nenit 41 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (Ligjit Nr.03/L-006), i cili përcakton se kompetencën e veçantë territoriale (kompetence territoriale ekskluzive) të gjykatave në territorin e të cilit gjendet paluajtshmëria, për kontestet lidhur me të drejta mbi sendet e paluajtshme, meqenëse edhe objekt kontesti ishte vërtetimi pronësie, rezulton se çështje nuk bie në domenin e kompetencës lëndore të Gjykatës Komerciale. Kështu në bazë të këtyre dispozitave kolegji i kësaj gjykate vlerëson se kompetente për të vendosur në këtë çështje është Gjykata Themelore në Mitrovicë Departamenti i Përgjithshëm.

Gjykata e shkallës së dytë i shqyrtoi pretendimet ankimore të paditësit, por gjeti se të njëjtat janë të pa bazuara, pasi që gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitat e nenit 13 të Ligjit për Gjykatë Komerciale , si dhe nenit 12 dhe 20 të Ligjit për Gjykata (Ligji nr. 06/L-054), e edhe bazë nenit 41 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (Ligjit Nr.03/L-006), të cilat në tërësi i aprovon edhe kjo gjykatë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 13 paragrafi 1.7 të Ligjit për Gjykatën Komerciale si dhe lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.Dh.Shk.II.nr.1133/24, me datën 10.10.2024

Gj y q t a r j a,
Franciska Zhitija Ymeri